



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

KPPP.nr 2394/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përmbartimore të kreditorit Kralini Group Sh.p.k, me nr. unik identifikues 811305334, e cila sipas autorizimit përfaqësohet nga A.SH., avokat nga Prishtina, kundër debitorit N.P.T “Florenti” me numër unik identifikues 811305334 Sh.a me, me seli në rr. “ Shemi Ahmeti” Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr. 277/22 të datës 14.10.2022, të lejuar nga Përmbartues Privat Irfan I.Kërçagu nga Prishtina, jashtë seancës me datën 31.07.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit N.P.T “Florenti” i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr. 277/22 të datës 14.10.2022, të lejuar nga Përmbartues Privat Irfan I.Kërçagu.
- II. Urdhri Përmbartimor P.nr. 277/22 i datës 14.10.2022, i lejuar nga Përmbartues Privat Irfan I.Kërçagu MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Kralini Group Sh.p.k, ka lëshuar urdhrin P.nr. 277/22 të datës 14.10.2022, duke lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit Faturë nr. 2022-KG-333 e datës 31.01.2022, me të cilin e ka urdhëruar debitorin që në emër të borxhit të përcaktuar sipas faturës së lartcekur t’ia paguaj kreditorit shumën prej 656.56 EUR (gjashtëqind e pesëdhjetë e gjashtë euro e pesëdhjetë e gjashtë cent) me kamatë ligjore prej 8 % nga data 31.01.2022 e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës për përpilimin e propozimit për përmbartim në shumën prej 104€ shpenzimet për avokatin aq sa do të krijohen deri në përfundim të kësaj procedure.

Debitori brenda afatit ligjor ka parashtruar Prapësim duke kundërshtuar në tërësi Urdhri Përmbartimor, me arsyetimin se faturat nuk janë të përshtatshme për përmbartim sepse koha është e lidhur ngushtë me barazimin e kartelave financiare pasi që përmbartimi varet nga përmbushja paraprake e një detyrimi në pajtim me nenin 32 par 1 lidhur me par.3 të LPP-së. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorit dhe të anulohet urdhri përmbartimor.

Kreditori në përgjigjen në prapësim ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim duke shtuar se debitori nuk ka paraqitur asnjë provë lidhur me vonesat mbi detyrimin me furnizim nga ana e kreditorit, andaj qëllimi i debitorit është vetëm zvarritja e procedurës përmbartimore. I ka propozuar Gjykatës që të refuzohet si i pa bazuar prapësimi i debitorit.

Gjykata, pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe deklarimeve të kreditorit në përgjigje ndaj prapësimin, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me nën-par.1.3 të këtij neni fatura përcaktohet si një nga dokumentet e besueshme, kurse me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, dhe me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*.

Gjykata në rastin konkret vlerëson se Fatura nr. 2022-KG-333 e datës 31.01.2022, në bazë të së cilës është lejuar përmbartimi i përmban të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Tutje Gjykata gjeti se fatura e lartcekur është pranuar në mënyrë të rregullt nga ana e debitorit, fakt ky që nga nënshkrimi dhe vula e debitorit si në faturë, dhe e njëjta i është bashkangjitur propozimit për përmbarim në original, dhe si e tillë paraqet bazë për lejimin e përmbarimit pasi që është e përshtatshme për përmbarim.

Gjykata pati parasysh pretendimet e debitorit se në rastin konkret kreditori nuk ka përmbushur detyrimin e tij i cili ka qenë barazimi i saldove financiare mirëpo gjeti se i njëjti nuk ka ofruar asnjë provë në kuptim të nenit 69.4 të LPP-së për t'i mbështetur pretendimet e tilla, e rrjedhimisht nuk ekziston asnjëra nga shkaqet e parashikuara me nenin 71 të LPP-së mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 par të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr 2394/22 datë 31.07.2023

Gjyqtari

Florent Zeqiri

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.